Hidromorava Gjilan

Kompania Rajonale e Ujësjellësit
"Hidromorava" SH.A.
Regionalna Kompanija za Vodovod
" Hidromorava" D.D
Regional Company for Water
"Hidromorava" J.S.C
Gjilan

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Nr. Prot. 613
Br. Prot. 4600
Prot.No.
Datë: 30.05.24
Datum.
Date:
PRISHTINË A NO.1

Hidromorava Gjilan KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT HIDROMORAVA Sh.a.
No. 637 Data 29.05.2024
GJILAN

Për:	Z. Valon Prebreza – Udhëheqës në Njësinë për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike – Ministria e Ekonomisë
Nga:	Znj. Filloretë Gashi Sadiku – Kryesuese e Bordit të Drejtorëve të KRU "Hidromorava"- SH.A. në Gjilan
Përmes:	Znj. Ajsun Abdullahu Sadiku – Sekretare e KRU "Hidromorava"- SH.A.
Lënda:	Raporti i Tremujorit të Parë për vitin 2024 të punës së Bordit të Drejtorëve dhe Ekzekutivit në KRU "Hidromorava" Sh.A. në Gjilan.
Datë:	29.05.2024

I nderuari z. Prebreza

Bordi i Drejtorëve me synim të përmbushjes së misionit dhe kryerjes së detyrave të tij në mënyrë sa më efikase dhe në pajtim me nenin 31.2. të Ligjit nr.04/L-111 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit bazik nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dërgon Raportin për Tremujorin e Parë për vitin 2024 të punës së Bordit të Drejtorëve dhe Ekzekutivit në KRU "Hidromorava" Sh.A. në Gjilan.

Me respekt.

Raporti për tremujorin e parë (TM1) për vitin 2024 i Bordit të Drejtorëve dhe Ekzekutivit të KRU "Hidromorava"- Sh.A Gjilan

Vendimi: 5 /2024

Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan, miratoi Raportin e Tremujorit të parë për vitin 2024 të Ekzekutivit dhe Bordit të Drejtorëve, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më 29.05.2024.

	Delegoi	**Aprovoi**
Emri Mbiemri:	Kryeshefi Ekzekutiv Z.Ymer Salihu	Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve Znj. Filloretë Gashi Sadiku
Nënshkrimi:		
Data:	29.05.2023	29.05.2023

Hidromorava Gjilan KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT HIDROMORAVA Sh.a.
No. 635 Data 29.05.2024
GJILAN

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njesia Org. 0113 Nr. Prot. 4600
Org. Jedin Dr. Prot
Org Unit Prot.No.
Nr. i faqeve 1 Datë: 30.05.24
Broj stranica Datum:
No. pages
PRISHTINË/A NO.1

Hidromorava Gjilan

KOMPANIA RAJONALE PËR UJËSJELLËS "HIDROMORAVA"- SH.A.

RAPORTI I PUNËS
PËR TREMUJORIN E PARË TË VITIT 2024

Prill, 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV 4
1.1. Hyrje 4
1.2. Aktivitetet kryesore 4
1.3. Vendime dhe akte të tjera 8
2. BORDI I DREJTORËVE 11
2.1.Vendimet e Bordit të Drejtorëve 11
3. KOMISIONI I AUDITIMIT 12
3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit 12
4. ZYRA E SEKRETARIT 13
4.1. Struktura e të punësuarve 13
4.2. Çështjet gjyqësore 14
5. ZYRTARJA E LARTË FINANCIARE 17
6. RAPORT I ZYRËS SË PROKURIMIT 38
7. RAPORTI PËR CILËSI TË UJIT PËR TM1– 2024 40
7.1. Cilësia e ujit 40
8. DIVIZIONI PËR PRODHIMIN, IMPIANTET E UJIT DHE STACIONET E POMPIMI 42
8.1. Furnizimi me ujë 42
8.2. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit 42
8.3 Mirëmbajta e rrjetit të ujësjellësit 44
8.4. Mirëmbajta e rrjetit të kanalizimit 48

TABELAT

Tabela 1: Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet relevante gjatë tremujorit të parë vitit 2024 ... 4
Tabela 2: Takimet/punëtoritë e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 7
Tabela 3. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv 8
Tabela 4. Numri i të punësuarve në njësitë punuese 13
Tabela 5. Struktura gjinore e të punësuarve 13
Tabela 6. Lëndët e pranuara nga Gjykatat kompetente 14
Tabela 7. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m^3 17
Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m^3 17
Tabela 9. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€) 18
Tabela 10. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit 18
Tabela 11. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit 19
Tabela 12. Paraqitja grafike e shpenzimeve në € të TM1 për vitin 2024 19
Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për regjion TM1/2024 dhe TM1/2023 dhe plani TM1/2024 18
Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë e Gjilanit TM1 2024 dhe krahasimi me TM1 2023 19
Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësinë e Kamenicës TM1 2024 dhe krahasimi me TM1 2023 20

Tabela 16. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë e Vitisë për TM1 2024, krahasimi me TM1 2023 21
Tabela 17. Treguesit – të hyrat totale dhe shpenzimet operative për TM1 2024 dhe krahasimi me TM1 2023 22
Tabela 18. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë 31
Tabela 19. Stoqet 32
Tabela 20. Pasuritë tjera afatshkurtra 32
Tabela 21. Prona, pajisjet dhe impiantet 33
Tabela 22. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera për TM1 2024 34
Tabela 23. Gjithsej detyrimet afatshkurta 35
Tabela 24. Të hyrat shtyera 35
Tabela 25: Ekuiteti 35
Tabela 26. Të hyrat dhe shpenzimet 36
Tabela 27: Fitimi/humbja e periudhës 37
Tabela 28. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM1 të vitit 2024 - vlerë minimale 38
Tabela 29. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM1 të vitit 2024 – kuotim i çmimit 38
Tabela 30. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM1 të vitit 2024 – procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës 39
Tabela 31. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM1 të vitit 2024 – procedurë e hapur – vlerë e mesme 39
Tabela 32. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM1 të vitit 2024 – Aneks Kontratë 39
Tabela 33: Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 42
Tabela 34. Sasisa së ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar për tremujorin e parë të vitit 2024 krahasuar me raportin e tremujorit të parë të vitit 2023 43
Tabela 35. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë TM1- 2024 44
Tabela 36: Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit 46
Tabela 37. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM1/2024 48
Tabela 38. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM1/2024 në Gjilan 48

SHËNIMET SHPJEGUESE

Shënimet shpjeguese 1: Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë 31
Shënimet shpjeguese 2: Llogaritë e arkëtueshme 31
Shënimet shpjeguese 3: Stoqet 32
Shënimet shpjeguese 4: Pasuritë tjera afatshkurtra 32
Shënimet shpjeguese 5: Prona pajisjet dhe impiantet 33
Shënimet shpjeguese 6: Investimet në vijim/projektet 33
Shënimet shpjeguese 7: Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera për TM1 2024 34
Shënimet shpjeguese 8: Gjithsej detyrimet afatshkurtra 35
Shënimet shpjeguese 9: Të hyrat e shtyera 35
Shënimet shpjeguese 10: Gjithsej ekuiteti 35
Shënimet shpjeguese 11, 12 13: Të hyrat dhe shpenzimet 31 mars 2024 36
Shënimet shpjeguese 14: Fitimi (humbja) e periudhës 37

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV

1.1. Hyrje

Raporti i përket periudhës raportuese TM1 dhe ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative, përshkrimin e arritjeve të caqeve të planit të biznesit të kompanisë rajonale të ujësjellësit "Hidromorava" – SH.A. Gjilan.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 është hapur tenderi lidhur me aktivitetin "Fabrika e prodhimit të ujit në Velekincë", i cili është i një rëndësie të madhe për Ndërrmarrjen, duke e ditur se kjo fabrikë është në një gjendje jo të kënaqshme.

Gjithashtu, sfidë për Ndërmarrjen mbeten: inkasimi i borxheve të vjetra, zvogëlimi i humbjeve të ujit përmes identifikimit të kyçjeve ilegale si dhe atyre teknike, evitimi i rrjedhjeve të ujit në kohë sa më të shkurtë etj, për të cilat aktivitete është përgatitur "Plani i Veprimit për vitin 2024" dhe menjëherë është filluar me zbatimin e tij, fillimisht në fshatin Zhegër, e pastaj në Komunën e Vitisë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese menaxhmenti i Ndërmarrjes është fokusuar në një mbikëqyrje më të madhe në të gjithë sektorët punues konform aktiviteteve të ushtruara si në leximin e rregullt të ujëmatësve, efikasitetin e shtuar në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, sigurimin dhe montimin e ujëmatësve për konsumatorët me paushall, në detektimin e rrjedhjeve, vendosjen e bllokuesve në ujëmatës etj.

Problemet në fabrika dhe stacione të pompimit vazhdojnë të jenë shqetësuese për faktin se nuk është investuar në riparimin e tyre për një kohë të gjatë, sidomos probleme serioze ka në Fabrikën e Prodhimit në Velekincë për të cilën janë duke u përgatitur nevojat imediate për intervenim dhe pastaj të shpallim tender për riparim të atyre pjesëve që janë më të amortizuara.

1.2. Aktivitetet kryesore

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, krahas angazhimeve të përditshme në menaxhim të Ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv ka mbajtur edhe takimet e listuara në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet relevante gjatë periudhës TM1/2024

Nr.	Institucioni:	Data:	Qëllimi i takimit:
1.	Së bashku me Kryesuesen e Bordit, takim me përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë	11.01.2024	Diskutimi për projektet që KRU "Hidromorava" ka përgatitur për investime kapitale dhe mundësia që këto projekte të subvencionohen nga Ministria e Ekonomisë.
2.	Takim me Kryetarin e Komunës z. Sokol Haliti	12.01.2024	Diskutimi rreth disa fshatrave në Komunën e Vitisë, që sapo të jenë gati për pranim teknik të merren nën menaxhim nga KRU "Hidromorava"

3.	Së bashku me Kryesuesen e Bordit, takim pune me Agjencinë për Informim dhe Privatësi	23.01.2024	Diskutimi rreth kërkesave ligjore të parashtruara nga ky Agjencion, drejtuar KRU "Hidromorava"
4.	Takim me Këshillin e Ministrave në kuadër të Qeverisë së Kosovës	23.01.2024	Prezantimi i projekteve të përgatitura nga KRU "Hidromorava" për subvencionim nga Ministria e Ekonomisë, me ç'rast edhe janë aprovuar 710,000.00 € për katër projekte kapitale.
5.	Takim me Kryetarin e Komunës së Gjilanit z. Alban Hyseni dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike, Infrastrukturë dhe Banim z. Mentor Mihovci		Bashkërendimi i aktiviteteve të Komunës së Gjilanit dhe KRU "Hidromorava"
6.	Takim me Kryetarin e Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni	02.02.2024	Diskutimi për projektet që KRU "Hidromorava" dhe Komuna e Gjilanit i kanë përgatitur për investime kapitale dhe mundësia që këto projekte të subvencionohen nga Ministria e Ekonomisë.
7.	Udhëtim zyrtar në Bursa së bashku me Drejtorin e NJPMNP – së si dhe KE nga Prishtina dhe Ferizaji	07.02.2024 deri më: 10.02.2024	Vizita të organizuara nga Ujësjellësi i Bursës, në impiantin e trajtimit të ujit të pijes si dhe impiantin e trajtimit të ujërave të zeza dhe prezentim për UPF nga ekspertët e ujësjellësit në Bursa.
8.	Takim pune me ARRU dhe SHUKOS	12.02.2024	Diskutimi dhe prezantim i metodologjisë së procesit tarifor për vitin 2025 – 2027.
9.	Takim me Kryetarin e Komunës së Kamenicës, z. Kadri Rahimaj	13.02.2024	Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit për projektet e bashkëfinancuara nga KRU "Hidromorava", Komuna e Kamenicës dhe ME.
10.	Së bashku me Kryesuesen e Bordit dhe Drejtorin e NJPMNP, takim me Kryetarin e Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni	15.02.2024	Diskutim në lidhje me fazën në të cilën ndodhet Impianti i ujërave të zeza si dhe bashkërendimi i aktiviteteve të Komunës së Gjilanit dhe KRU "Hidromorava" për projektin e Ujësjellësit në fshatin Cërnicë.
11.	Takim pune me Avokatin e angazhuar të Ndërrmarjes, z. Hajredin Leka	20.02.2024	Diskutim për lëndët që janë në proces gjyqësor si dhe për rastin e humbur në Arbitrazh, me ç'rast kemi kërkuar që të përgatitet një shkresë për CDI, që të njoftohen me humbjen financiare që ka pasur KRU "Hidromorava".
12.	Takim pune në SHUKOS	23.02.2024	Është mbajtur mbledhja e rregullt e SHUKOS, ku ndër të tjera është miratuar edhe Plani i Punës dhe Buxheti për vitin 2024

13.	Mbledhja e rregullt e Bordit te KRU "Hidromorava"	28.02.2024	Eshtë mbajtur mbledhja e rregullt e Bordit te KRU Hidromorava, ku ndër të tjera është miratuar raporti i performancës financiare dhe operative dhe i pasqyrave financiare për vitin 2023
14.	Takim pune me këshilltarin e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoreshën e Shërbimeve Publike të Novobërdës.	01.03.2024	Diskutimi për projektet e ujësjellësit në Komunën e Novobërdës si dhe rritja e bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve.
15.	Vizitë pune nga ministrja e ME, znj. Rizvanolli dhe bashkëpunëtorët e saj. Në vizitë përveç Menaxhmentit të Ndërmarrjes ishin të ftuar edhe Bordi i KRU "Hidromorava".	06.03.2024	Vizita e ministres Rizvanolli është bërë në FPU Velekincë, me që rast ajo u informua për së afërmi me gjendjen e fabrikës, si dhe investimet që do të bëhen në këtë fabrikë në vlerë prej 200,000.00€ të subvencionuara nga ME.
16.	Kuvendi i rregullt i SHUKOS	08.03.2024	Në Kuvendin e SHUKOS janë prezentuar pasqyrat financiare si dhe arritjet gjatë vitit 2023. Në këtë Kuvend gjithashtu është zgjedhur edhe nënkryetari i SHUKOS, z. Ymer Salihu nga KRU "Hidromorava" Gjilan.
17.	Takim në ARRU. Në takim kanë marrë pjesë të gjithë KE-të nga të gjitha KRU-të.	15.03.2024	Në këtë takim është diskutuar për procesin tarifor për vitin 2024, me ç'rast edhe janë nënshkruar marrëveshjet me të gjitha KRU-të, gjithashtu është theksuar rëndësia e sinkronizimit të PB-ve me PMA-të, në mënyrë që investimet të bëhen në asetet me kritikalitet më të lartë.
18.	Takim: Kryetari i Komunës së Novobërdës, Menaxheri i Kontratës së Impijantit, si dhe zyrtari i Kadastrit nga Komuna e Gjilanit.	18.03.2024	Gjatë këtij takimi është kërkuar nga Kryetari i Novobërdës që ta mbështet shpronësimin e pronave përmes së cilave do të kalojnë kolektorët e Impijantit, si dhe i është sqaruar se kjo është në të mirë edhe të komunitetit nga do të kalojnë këta kolektorë, pasi që do të largohen ujërat e zeza nga ato lokacione.
19.	Takim pune me Kryetaren e Komunës në Ranillug, në takim ishin prezent edhe përfaqësuesit e OSBE.	20.03.2024	Në takim u diskutua ngritja e bashkëpunimit në mes të Komunës së Ranillugut dhe KRU "Hidromorava" ku nga ky takim u dakordua që Komuna të na mbeshtetë në lidhje me inkasimin e borxheve të vjetra si dhe në identifikimin e keqpërdorusve të ujit, në mënyrë që furnizimi me ujë të jetë i rregullt për të gjithë banorët e kësaj Komune.
20.	Këshilli i Ministrave i Qeverisë së Kosovës.	29.03.2024	Në këtë takim është prezantuar dhe arsyetuar projekti për "Ndërtimin e ujësjellësit në fshatin Cernicë", me ç'rast ME për këtë projekt ka ndarë 450,000.00€.

Tabela 2. Takimet/punëtoritë e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM1/2024

Nr.	Takime pune:	Data:	Qëllimi i takimit
1.	Takim me përfaqësuesit e projektit FLOWS – Banka Botërore	24.01.2024	Diskutimi rreth procedurave që duhet ndjekur për ndikimin social të projektit FLOWS.
2.	Takim pune/punëtori e organizuar nga OJQ "SHPRK" në Kosovë.	30.01.2024	Takim i organizuar në kuadër të projektit "Analiza funksionale e kapaciteteve komunale në pellgun lumor të Moravës së Binçes dhe asistencë juridike për zbatimin e Ligjit për Ujëra".
3.	Takim pune me konsulentin e Impiantit të ujërave të zeza, znj. Edit Kovacs dhe Arian Dragaqina	20.02.2024	Diskutimi rreth procesit të shpronësimit për trasenë nga do të kalojnë kolektorët e Impiantit të Ujërave të Zeza, në Komunat Gjilan, Partesh dhe Novobërdë.
4.	Takim pune me përfaqësues të OSBE-së	21.02.2024	Diskutim rreth mirëmbajtjes dhe investimeve në ujësjellës në fshatrat e banuara me serbë, si dhe bashkëpunimi i KRU "Hidromorava" me Kryetarët e këtyre Komunave.
5.	Takim pune me përfaqësuesit e projektit FLOWS – Banka Botërore	27.02.2024	Punëtori e organizuar nga FLOWS : "Praktikat e Mira Globale për Planifikimin e Investimeve në Diga, Sigurinë e Digave dhe Funksionimin e Digave"
6.	Përfaqësuesit e Bankës Botërore.	12.03.2024	Gjate takimit theks të veçantë i është dhënë prioriteteve të fillimit të investimeve nga Projekti FLOWS, ku është rënë dakord që investimet të fillojnë në ato pjesë ku nuk ka nevojë të pritet për pëlqimet e qytetarve.

1.3. Vendime dhe akte të tjera

Në kudër të detyrave dhe përgjegjësive të tij, Kryeshefi Ekzekutiv gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 ka nxjerrë 21 vendime të listuara si më poshtë:

Tabela 3. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM1/2024

Nr.	Vendimi:	Numri i Vendimit:	Data e protokollimit:
1.	Vendim për pranimin në marrëdhënie pune për kohë të caktuar katër (4) punëtorë, dy (2) në Nj.O. Viti, një (1) në Gjilan dhe një (1) në Nj.O. Kamenicë.	3	09.01.2024
2.	Vendim mbi pagesën e taksës për shfrytëzimin e ujit nga ujërat nëntokësorë për burimin "Baja", fsh. "Përlepnicë", "Guri i Hoxhës", "liqeni – Penda në fsh. Përlepnicë", "Letnicë", "Viti", puset në Kamenicë dhe fshatin Velekincë.	12	11.01.2024
3.	Vendimin për formimin e komisionit për pranimin teknik të punëve lidhur me projektin "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Karaqevë e Epërme, në Komunën e Kamenicës.	28	12.01.2024
4.	Vendimi për formimin e komisionit për pranimin teknik të punëve lidhur me projektin "Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Zhiti, Komuna e Vitisë.	29	12.01.2024
5.	Vendimi për dhënien e ndihmës materiale punëtorit Sadulla Ibrahimi në shumë prej 150.00€, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babait), konform Rregullores për kompenzimin e udhëtimit zyrtar, gradimeve dhe ndihmave solidare.	68	24.01.2024
6.	Vendimi për dhënien e ndihmës materiale punëtorit Shkelzen Balaj në shumë prej 150.00€, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babait), konform Rregullores për kompenzimin e udhëtimit zyrtar, gradimeve dhe ndihmave solidare.	69	24.01.2024
7.	Vendim për dhënjen e ndihmës solidare në shumë prej dy pagave mujore, me rastin e vdekjës së punëtorit Muharrem Azemi.	70	24.01.2024
8.	Vendimi për lejimin e pushimit të lehonisë punëtores Donjeta Morina, zyrtare për konsumatorë në Nj.O. në Kamenicë, në kohëzgjatje prej 12 muaj, konform nenit 49. Paragrafi 1. të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës në Kosovë.	71	24.01.2024

9.	Vendim për caktimin e zyrtares kontaktuese në KRU "Hidromorava"-SH.A, znj. Ajsun Abdullahu Sadiku për pranimin e kërkesave dhe informatave nga Agjencioni për Parandalimin e Korrupsionit, konform Ligjit Nr.08/L-018 për Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, dhe të Ligjit Nr.08/L-017 për Parandalimin e Korrupsionit.	117	06.02.2024
10.	Vendim për caktimin e anëtarëve (në koordinim me Komunën e Gjilanit) për themelimin e komitetit të komunitetit për projektin FLOWS, që kanë për detyrë të përfaqësojnë Institucionet, pronarët të cilët afektohen nga punimet që planifikohen të zhvillohen.	120	08.02.2024
11.	Vendim për caktimin e anëtarëve (në koordinim me Komunën e Kamenicës), për themelimin e komitetit të komunitetit për projektin FLOWS, që kanë për detyrë të përfaqësojnë institucionet, pronarët të cilët afektohen nga punimet që planifikohen të zhvillohen.	121	08.02.2024
12.	Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dt. 20.02.2024 të punësuarit Shaban Musliu për shkak se i njejti ka mbushur moshën e pensionit prej 65 vjet.	163	16.02.2024
13.	Vendimin për caktimin e zyrtarit për Mbrojtjen e të dhënave personale z. Valon Maliqi, konform Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të dhënave personale.	181	23.03.2024
14.	Vendim për lejimin e dhënies së ndihmës materiale punëtores Edona Gashi në shumë prej 150,00 €, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babait), konform Rregullores për kompenzimin e udhëtimit zyrtar, gradimeve dhe ndihmave solidare.	203	26.02.2024
15.	Vendim për lejimin e dhënies së ndihmës materiale punëtores Rina Ahmeti në shumë prej 150,00 €, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babait), konform Rregullores për kompenzimin e udhëtimit zyrtar, gradimeve dhe ndihmave solidare	204	26.02.2024
16.	Vendim për angazhimin e një (1) personi sipas Kontratës mbi Veprën në kohëzgjatje prej një muaji si "mjeshtër për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit" në Nj.O. – Viti.	225	01.03.2024
17.	Vendim për caktimin e zyrtarit kontaktues në KRU "Hidromorava" Sh.A. për pranimin, evidentimin dhe kontrollin e regjistrit të dhuratave, konform dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.	242	06.03.2024
	Vendim për shfrytezimin e një veture private nga Menaxheri i rrjetit të kanalizimit për pjesëmarrjen e tij në implementimin e projektit FLOWS në Shkup, Republika e	254	11.03.2024

18	Maqedonisë Veriore për datën 07.03.2024, duke iu pranuar shpenzimet e udhëtimit konform nenit 7 paragrafi 3. të Rregullores mbi shfrytëzimin e veturave zyrtare në KRU "Hidromorava"- SH.A.		
19.	Vendim për për shpalljen e konkursit publik për vendet e lira të punës në Nj.O. – Viti, për pozitat një /1/ operator në FPU" Letnicë, një (1) lexues të ujëmatësve/inkasant dhe një (1) mjeshtër në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit.	320	25.03.2024
20.	Vendimin për lejimin e dhënies së ndihmës materiale të punësuarit Ramadan Shabani në shumë prej 150.00 €, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babait), konform Rregullores për kompenzimin e udhëtimit zyrtar, gradimeve dhe ndihmave solidare.	330	26.03.2024
21.	Vendim për lejimin e dhënies së ndihmës materiale punëtorit Isuf Matoshi në shumë prej 150.00 €, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (babait), konform Rregullores për kompenzimin e udhëtimit zyrtar, gradimeve dhe ndihmave solidare.	331	26.02.2024

2. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 ka mbajtur tri /3/ mbledhje të rregullta.

2.1.Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve gjithmonë është bërë në mënyrë të lirë dhe demokratike duke e respektuar të drejtën e votimit të lirë, pa presion dhe vendosjes me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

Bordi i Drejtorëve në tremujorin e parë të vitit 2024, bazuar në procesverbalet të dt. 30.01.2024, 28.02.2024, 26.03.2024 ka marrë këto vendime:

- Bordi i Drejtorëve, ka miratuar raportet për muajt: dhjetor, janar dhe shkurt me plotësim ndryshime;
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 28.02.2024 ka miratuar Raportin Vjetor për vitin 2023 me plotësim ndryshimet e rekomanduara;
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 28.02.2024 ka miratuar Raportin e TM4 për vitin 2023 të Ekzekutivit dhe të Bordit të Drejtorëve;
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 28.02.2024 me pesë vota pro ka miratuar futjen në organogram të pozitave të inspektorëve të Ndërmarrjes, sipas planit të biznesit;
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 26.03.2024 ka miratuar unanimisht "Raportin e kënaqshmërisë së konsumatorëve për vitin 2023";
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 26.03.2024 ka miratuar organogramin e ri të propozuar nga Kryeshefi Ekzekutiv[1];

[1] Te pozita e Sekretarit, konkretisht te Menaxheri i Burimeve Njerëzore shtohen:

1. Zyrtar i burimeve njerëzore
2. Zyrtari për mbrojtje dhe siguri në punë (është zhvendosur linja e raportimit nga Sekretari tek Menaxheri i burimeve njerëzore).

➢ Te pozita e Sekretarit është shtuar edhe një pozitë e re nën udhëheqjen direkte nga Sekretari:

1. Sigurimi

➢ Pozita "Përgjegjës i lexuesve të ujëmatësve" ka qenë si "Shef i lexuesve të ujëmatësve" dhe tani vetëm është përmirësuar teknikisht, e cila pozitë ende nuk është e përmbushur.

➢ Te Divizioni për Planifikim dhe Zhvillim shtohet edhe "Zyra për Projekte" e cila përfshinë Shefin dhe inxhinierët për të ardhmen.

➢ Te Zyra e Kryeshefit:

1. Shuhet pozita e "Zyrtares për Media dhe Marrëdhënie me Publikun".

3. KOMISIONI I AUDITIMIT

Komisioni i Auditimit gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 ka mbajtur tri /3/ mbledhje të rregullta dhe bazuar në procesverbalet të dt. 30.01.2024, 28.02.2024, 26.03.2024 ka marrë këto vendime:

3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit

- Komisioni i Auditimit, në mbledhjën e mbajtur më datë: 13.02.2024 ka miratuar Draft Pasqyrat Financiare për vitin 2023;
- Komisioni i Auditimit, në mbledhjën e mbajtur më datë: 22.02.2024 ka miratuar ka miratuar Raportin Vjetor për vitin 2023, me plotësim ndryshimet e rekomanduara në këtë mbledhje të Komisionit të Auditimit;
- Komisioni i Auditimit, në mbledhjën e mbajtur më datë: 18.03.2024 ka miratuar Draft raportin Final i Auditimit mbi Ligjshmërinë e Realizimit të Projektit – "Ndërtimi i Rrjetit të Ujësjellësit në fshatin Karaçevë e Epërme në Komunën e Kamenicës";
- Komisioni i Auditimit, në mbledhjen e mbajtur më: 18.03.2024 ka miratuar Draft Raporti mbi Ligjshmërinë e Projektit Kapital "Kyçjet Individuale për fshatrat Hodonoc dhe Dajkoc në Komunën e Kamenicës – Situacioni i III-të;

4. ZYRA E SEKRETARIT

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, janë protokolluar dhe arkivuar 455 akte nga shërbimi juridik. Gjatë këtij tremujori janë mbajtur gjithsej nëntë /9/ mbledhje të rregullta të menaxhmentit.
Gjithashtu, janë lëshuar akte si: urdhëresa, lajmërime, njoftime, vërtetime të ndryshme konsumatorëve dhe punëtorëve të Ndërmarrjes për nevoja personale, vendime për pushime vjetore, autorizime, kërkesa, përgjigje në kërkesa dhe ankesa të ndryshme. Janë iniciuar trembëdhjetë /13/ kallëzime penale ndaj konsumatorëve të pandërgjegjshëm dhe gjatë periudhës raportuese në zyrën për konsumator janë pranuar 40 ankesa me shkrim, me ç'rast Komisioni për shqyrtimin e ankesave i ka shqyrtuar të gjitha.

4.1. Struktura e të punësuarve

KRU "Hidromorava"- Sh.A Gjilan, ka operuar me gjithsej 165 të punësuar.

Tabela 4. Numri i të punësuarve në njësitë punuese për periudhën TM1/2024

Numri i të punësuarve në njësitë e caktuara punuese	Gjilan	Kamenicë	Viti
	126	19	20

Tabela 5. Struktura gjinore e të punësuarve për periudhën TM1/2024

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë gjinore	Numri i të punësuarve (meshkuj)	Numri i të punësuarave (femra)	Numri total i të punësuarve
	142	23	165

4.2. Çështjet gjyqësore

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, KRU "Hidromorava"- SH.A. në Gjilan, nga ana e gjykatave kompetente ka pranuar lëndët e paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 6. Lëndët e pranuara nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës TM1/2024

Lëndët e pranuara nga gjykatat kompetente			
Datë	**Institucioni**	**Nr. Aktvendimit**	**Arsyetimi**
25.01.2024	Gjykata e Apelit e Kosovës-Prishtinë	Ac.nr.5799/2022 dt.20.12.2023	Aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit Avdulla Hamiti nga Gjilani, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.449/2021 i dt. 28.06.2022, prishet dhe çështja i kthehet të njejtës gjykatë në rivendosje, për shkak rrogave jubilare.
25.01.2024	Gjykata e Apelit e Kosovës, Prishtinë	Ac.nr.2498/2022 i dt. 20.12.2023	Refuzohen si të pa bazuara ankesat e paditësve Abdylaziz Selmani, Byrete Bajrami, Agim Mehmeti dhe Ilir Uruqi që të gjithë nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 448/2021 i dt. 07.03.2022, Vërtetohet për shkak kompensimit të rrogave jubilare.
08.02.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	P.nr. 461/2023 i dt. 30.12.2023	Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.461/2023 të dt. 30.12.2023, i pandehuri Shkelzen Gashi nga Gjilani, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 315, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. lidhur me nenin 28 të KPRK-së".
12.02.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	CPK.nr.85/2023 i dt. 08.02.2024	Është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Mustafë Ibrahimi nga Gjilani, ndërsa urdhëri përmbarimor P.nr. 333/23 i dt. 21.08.2023 mbetet në fuqi, për shkak borxhit në vlerë prej: 790.46 €.

14.02.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	P.nr. 675/2023 i dt. 08.02.2024	Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr. 675/2023 i dt. 08.02.2024, i pandehuri Mejdi Bislimi nga fshatin Zhegër, Komuna Gjilan, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së".
14.02.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	P.nr.682/2023 i dt. 07.02.2024	Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 682/2023 i dt. 07.02.2024, i pandehuri Nasret Zeqiri nga fshatin Kmetoc, Komuna Gjilan, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së".
14.02.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	P.nr. 911/2023 i dt. 08.02.2024	Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 911/2023 i dt. 08.02.2024, i pandehuri Agron Sadriu Zeqiri nga Gjilani, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së".
14.02.2024	Gjykata Themelore në Gjilan- Departamenti i përgjithshëm	P.nr.671/2023 i dt. 08.02.2024	Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 671/2023 i dt. 08.02.2024, i pandehuri Fadil Osmani nga fshatin Vërbicë e Kmetocit, Komuna Gjilan, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së".
14.02.2024	Gjykata Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm	P.nr.680/2023 i dt. 07.02.2024	Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 680/2023 i dt. 07.02.2024, i pandehuri Shukri Sherifi nga Gjilani, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314 Paragrafi 1 të KPRK-së".
29.02.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	P.nr.689/2023 i dt. 26.02.2024	Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, P. nr. 689/2023 i dt. 26.02.2024, i pandehuri Imrush Vokshi nga fshatin Velekincë, Komuna Gjilan, është shpallur fajtor për veprën penale "vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së".

29.02.2024	Gjykata Komerciale e Kosovës në Prishtinë – Dhoma e shkallës së dytë	K.DH.SH. II. nr. 410/23 i dt.05.09.2023	Me Aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, K.DH.SH.II.nr.410/23, i dt. 05.09.2023, është aprovuar si e themeltë ankesa e kreditorit KRU "Hidromorava"-SH.A. duke e anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë PPP.nr.29/2021 të dt. 30.06.2022, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale, Dhomës së Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje, për shkak të borxhit në vlerë prej 1,372.92€.
04.03.2024	Gjykata e Apelit e Kosovës-Prishtinë	Ac.nr. 3234/2022 i dt. 07.02.2024	Me Aktvendimin Ac.nr.3234/2022 të dt.07.02.2024,është hudhur poshtë si e pa afatshme ankesa e paditësit Enver Shabani nga Gjilani, e parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.454/21 të datës 07.03.2022, për shkak kompensimit të rrogës jubilare.
18.03.2024	Gjykata e Apelit në Prishtinë	C.A.P. nr. 1573/2023 i dt.08.03.2024	Me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, C.A.P. nr.1573/2023 të dt.08.03.2024, është refuzuar si e pathemeltë ankesa e debitorit Isuf Mehmeti nga Gjilani, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan CPK.nr.120/22 i dt. 03.10.2023, vërtetohet.
27.03.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	CPK.119/2023 i dt.25.03.2024	Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – CPK.119/2023 i dt. 27.03.2024, është aprovuar pjesërisht prapësimi i debitorit Miftar Islami nga Gjilani, me të cilën nga borxhi total në vlerë prej: 1,744.51€, të njejtit i është parashkruar borxhi në vlerë prej 1,718.51€, ndërsa borxhi për pagesë ndaj kreditorit është në vlerë prej 26.00€, kundër këtij aktvendimi kreditori ka parashtruar ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

5. ZYRTARJA E LARTË FINANCIARE

5.1. Aktivitetet kryesore

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, janë zhvilluar aktivitetet e zakonshme sa i përket departamentit financiar si: kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme dhe llogarive të arkëtueshme, raportet ditore nga shërbimi i arkave, barazimi i gjendjeve bankare, kontimet, shkarkimet nga pagesat të cilat transferohen nga insitucionet mikro financiare dhe bankare, kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre, përgatitjet e pagave, plotësimi i librave të blerjes dhe shitjes sipas formës së kërkuar nga ATK-ja për muajin përkatës dhe tremujore, deklarimi i tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave sipas ligjit në fuqi.

5.2. Shqyrtimi performancës operative dhe financiare

5.2.1. Prodhimi i ujit në m^3

Prodhimi i ujit në m^3 për TM1/2024 në krahasim me TM1/2023 ka rritje për 6.67 %, ndërsa sa i përket arritjes së cakut të planifikuar është tejkaluar për 12.73 %.

Tabela 7. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m^3



5.2.2. Faturimi i ujit në m^3

Faturimi i ujit në m^3 për TM1/2024 në krahasim me TM1/2023 ka shënuar rritje për 1.65 %, ndërsa sa i përket arritjes së cakut të planifikuar, është nën plan për 25 %.

Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m^3



5.2.3. Faturimi i ujit në euro (€)

Faturimi i ujit në euro (€) në TM1/2024 në krahasim me TM1/2023 ka rritje 1.82 %, ndërsa sa i përket realizimit të planit, ai është arritur në masën 89.04 %.

Tabela 9. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)



5.2.4. Arkëtimi i ujit

Arkëtimi i ujit për TM1/2024 në krahasim me TM1/2023 ka shënuar rritje për 18.65%. Arkëtimi nga borxhet e vjetra ka ndikuar në rritje të normës së arkëtimit, ndërsa sa i përket realizimit të planit, ai është tejkaluar për 8.12.- korigjuar

Tabela 10. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit

5.2.4.1.Përqindja e arkëtimit

Përqindja e arkëtimit nga faturimi për TM1/2024 në krahasim me TM1/2023 ka rritje për 18.65 %, ndërsa sa i përket realizimit të planifikuar ka arritur tejkalim për 21.43

Tabela 11. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit- korigjuar



5.2.6. Shpenzimet

Shpenzimet në TM1/2024 në krahasim me TM1/2023, kanë shënuar rritje për 14.24 %. Arsyeja e rritjes është për shkak të rritjes së stafit, gjoba e ekzekutuar dhe të tjera.

Tabela 12. Paraqitja grafike e shpenzimeve në € të TM1/2024



Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për regjion TM1/2024 dhe TM1/2023 dhe plani TM1/2024

Indikatorët- Regjion	TM1 /2024	TM1 /2023	Realizimi 2024/2023	Trendi 2024/2023	Plani TM1 /2024	Realizimi i planit [%]	Tirendi TM1 2024 me Planin
Prodhimi i ujit [m^3]	2,091,229	1,960,492	106.67	poz	1,855,000	112.73	poz
Faturimi [m^3]	932,624	917,529	101.65	poz	1,109,017	84.09	neg
Uji i pafaturuar [m3]	1,158,605	1,042,963	111.09	neg	745,983	64.39	neg
Faturimi [€]	545,022	535,296	101.82	poz	612,096	89.04	neg
Arkëtimi [€]	619,203	521,884	118.65	poz	572,668	108.13	poz
Shkalla e arkëtimit [%]	113.61	97.49	116.53	poz	93.56	121.43	poz
Shpenzimet [€][2]	572,304	500,964	114.24	neg	561,600	98.13	neg
Numri i konsumatorëve të regjistruar (total)	42,272	40,139	105.31	poz	41,503	101.85	poz
Numri i konsumatorëve me ujëmatës [nr]	38,332	36,273	105.68	poz	38,310	100.06	poz
Numri i konsumatorëve me konsum zero [nr]	20,256	18,379	110.21	neg	14,100	69.61	neg
Konsumatorë të rinj [nr]	601	532	112.97	poz	360	166.94	poz
Numri i konsumatorëve aktiv [nr]	38,475	36,468	105.50	poz	38,405	100.18	poz

[2] a) Shpenzimet e pagave: shtim i stafit të ri 29,953.00 €;

b) Shpenzimi për gjobën nga ekzekutimi arbitrazhit 47,282.00 € (27,688.14 kamatë 8% në emër të punëve të kryera, kamatë shtesë: 11,566.71 €, procedura përmbarimore: 1,142.65 €, shpenzimet e arbitrazhit: 6,884.40 €;

c) Shpenzimet për mirëmbajte të rrjetit 8,741.00 €.

Numri i konsumatorëve pa ujëmatës	143	195	73.33	poz	130	90.91	neg
Faturimi i ujit me ujëmatës [m^3]	931,540	908,756	102.51	poz	1,106,244	84.21	neg
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës [%]	99.63	99.47	100.16	poz	99.75	99.88	neg
UPF në [%]	55.40	53.20	104.14	neg	40.21	72.59	neg
Norma e Mbulimit operativ	0.95	1.07	89.13	neg	1.02	93.39	poz
Fitimi / humbja operative	(27,282)	34,332	-79.47	neg	11,068	-40.57	neg
Kostoja për Njësi [€/m^3]	0.27	0.26	107.10	neg	0.30	110.63	poz
Efikasiteti i stafit ['000 kons]	4.42	4.22	104.74	neg	4.48	101.36	poz

Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë e Gjilanit TM1/2024 dhe krahasimi me TM1/2023

	Indikatorët – Gjilan	TM1 /2024	TM1 /2023	Realizimi 2024/2023	Trendi 2024/2023
1	Prodhimi i ujit [m³]	1,530,254	1,566,284	97.70	neg
2	Faturimi [m³]	747,321	729,626	102.43	poz
3	Uji i pafaturar [m3]	782,933	836,658	93.58	poz
4	Faturimi [€]	437,361	428,415	102.09	poz
5	Arkëtimi [€]	520,124	428,840	121.29	poz
6	Shkalla e arkëtimit [%]	118.92	100.10	118.81	poz
7	Shpenzimet [€]	454,053	392,690	115.63	neg
8	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	32,375	30,857	104.92	poz
9	Numri i konsumatorëve me ujëmatës [nr]	30,151	28,718	104.99	poz
10	Numri i konumatorëve me konsum zero [nr]	15,518	14,291	108.59	neg
11	Konsumatorë të rinj [nr]	514	439	117.08	poz
12	Numri i konsumatorëve aktiv [nr]	30,248	28,836	104.90	poz
13	Numri i konsumatorëve pa matje [nr]	97	118	82.20	poz
14	Faturimi i ujit me ujëmatës [m³]	746,740	729,163	102.41	poz
15	Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës [%]	99.68	99.59	100.09	poz
16	UPF në [%]	51.16	53.42	95.78	poz
17	Norma e mbulimit operativ	0.96	1.09	88.29	neg
18	Fitimi/humbja operative	-16,692.00	35,725.00	-46.72	neg
19	Kostoja për njësi [€/m³]	0.30	0.25	118.35	neg
20	Efikasiteti i stafit ['000 kons]	4.33	3.98	108.79	neg

Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësinë e Kamenicës TM1/2024 dhe krahasimi me TM1/2023

	Indikatorët – Kamenicë	TM1/2024	TM1/2023	Realizimi 2024/2023	Trendi 2024/2023
1	Prodhimi i ujit [m^3]	177,093.00	161,068.00	109.95	poz
2	Faturimi [m^3]	102,816.00	89,697.00	114.63	poz
3	Uji i pafaturar [m3]	74,277.00	71,371.00	104.07	neg
4	Faturimi [€]	56,850.00	51,577.00	110.22	poz
5	Arkëtimi [€]	50,512.96	49,791.66	101.45	poz
6	Shkalla e arkëtimit [%]	88.85%	90.16	0.99	neg
7	Shpenzimet [€]	60,374.00	54,659.00	110.46	neg
8	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	5,360.00	5,285.00	101.42	poz
9	Numri i konsumatorëve me ujëmatës[nr]	4,252	4,199	101.26	poz
10	Numri i konumatorëve me konsum zero [nr]	2,319	2,317	100.09	neg
11	Konsumatorë të rinj [nr]	4	5	80.00	neg
12	Numri i konsumatorëve aktiv [nr]	4,252	4,199	101.26	poz
13	Numri i konsumatorëve pa matje [nr]	0	0	0	poz
14	Faturimi i ujit me ujëmatës [m^3]	102,816	89,697	114.63	poz
15	Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës [%]	100.00	100.00	100.00	poz
16	UPF në [%]	41.94%	44.31	0.95	neg
17	Norma e mbulimit operativ	0.94	0.91	103.37	poz
18	Fitimi/humbja operative	-3,524.00	-3,082.00	114.34	poz
